

V E N D I M
Nr.311, datë 12.5.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË STRATEGJINË E RISTRUKTURIMIT TË BANKËS SË
KURSIMEVE, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR.407, DATË 27.7.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Banka e Kursimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 1 paragrafi i tretë nëndarja e tretë dhe në pikën 2 paragrafi i pestë nëndarja e dytë të strategjisë së ristrukturimit të Bankës së Kursimeve, sh.a., miratuar me vendimin nr.407, datë 27.7.2000 të Këshillit të Ministrave shprehja “deri në 3 paga mujore” ndryshohet dhe zëvendësohet me shprehjen “deri në 12 paga mujore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta